



Datë: 23.01.2026

Numër Protokollit: 370//2026

A.nr.1978/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtare, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar në procedurën sipas ankesës A.nr.1978/2025, të datës 03.12.2025, të parashtruar nga ankuesi S.Th, nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.1978/2025, e datës 03.12.2025 e parashtruar nga ankuesi S.Th.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, S.Th, (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 03.12.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokollit 7689/2025, kundër mosveprimit të organit të punësimit lidhur me kërkesën e tij për udhëtime zyrtare jashtë vendit sipas opinion të zyrës ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.12.2025 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të jashtme dhe Diasporës (tutje: MPJD), ndërsa kjo e fundit më datë 15.12.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 15.01.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:146/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.1978/2025 të datës 03.12.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën e datës 03.12.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankuesit të datës 22.05.2025; Përgjigje e datës 27.05.2025 përmes e-mailit të dërguar nga A.M për ankuesin; Shkresën e datës 02.06.2025 dërguar nga D.K për Sh.V me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; Reagimin e ankuesit të datës 20.06.2025; Përgjigjen e Sh.V të datës 20.06.2025 dërguar për ankuesin; Vendimin Nr.535/2024 e datës 09.10.2024; Kërkesën e datës 07.10.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin e Kryetarit të Këshillit të datës 15.01.2025; Shkresë e datës 22.01.2026; Vendimin e datës 04.11.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Përgjigjen e datës 15.12.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë i Transportit; Akt Emërimit e datës 12.02.2025; Vendimin e datës 29.01.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Kërkesën e datës 10.01.2025; Vendimin e datës 09.10.2024; Vendimin e datës 28.07.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit e është ***e jashtëafatshme***, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit Nr.571 të datës 12.02.2025 është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pozitën “Zyrtar i lartë i transportit”, në kuadër të Divizionit për Logjistikë/Departamentit për Shërbime të Përgjithshme, ndërsa i njëjti me datë 22.05.2025 përmes e-mailit i është drejtuar zyrtarëve të zyrës ligjore në kuadër të MPJD-së, me kërkesën për opinion nëse i njëjti ka të drejtë që të realizojë udhëtime zyrtare jashtë vendit sikurse kolegët e tjerë.

Zyrtarët nga zyra ligjore, përmes e-mailit të datës 27.05.2025 i kanë kthyer ankuesit opinionin e kërkuar e që mes tjerash ka qenë raport me përmbajtje pozitive për ankuesin, sipas së cilit të njëjtit i kanë sugjeruar që Udhëheqësja e Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime e ka për obligim që të përgatisë planë të udhëtimeve ashtu që t’i jepet mundësia secilit zyrtar në mënyrë të drejtë dhe pa përjashtim të pjesëmarrjes në vizita jashtë vendit në kuadër të qëllimit të punës, duke pasur parasysh që çështja e udhëtimeve jashtë vendi ka beneficinet e saja, duke mos u ndier apo trajtuar në mënyrë të diskriminuar askush.

Ankuesi opinionin e bashkangjitur, me datë 27.05.2025 ia ka përcjellë udhëheqëses së tij të drejtpërdrejtë, Udhëheqëses së Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime, ndërsa e njëjta e ka përcjellë tek zyrtarët e tjerë të divizionit përkatës të cilët e kanë kundërshtuar një qëndrim të tillë, ashtu që Udhëheqësja e Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime, me datë 20.06.2025 lidhur me kërkesën e tij për të qenë pjesë e udhëtimeve jashtë vendit, i kthen përgjigjen ankuesit si në vijim, ***citohj:*** “.. *Ju njoftojë, se pas ankesave të vozitësve në EU-Zyra e Sekretarit më ka thirr në takim së bashku me vozitësit dhe Sekretari gojarisht më ka vendos që Ju të mos udhëtoni krahas vozitësve, të udhëtoni vetëm kur nuk janë*

të lira vozitësit ose në marrëveshje ndonjëherë”, ndërsa kjo përgjigje nuk përmbante edhe këshillën juridike, kurse ankuesi në po të njëjtin ditë me datë 20.06.2025 këtë përgjigje e kishte kundërshtuar në formë reagimi ndaj të njëjtës përgjigje, respektivisht udhëheqëses së drejtpërdrejtë dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, mirëpo nuk ka dëshmi apo prova se ankuesi të ketë ndjekur rrugët ligjore për të kundërshtuar përgjigjen e organit të punësimit sikurse e parasheh ligji material.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se organi i punësimit po i shkakton padrejtësi lidhur me ushtrimin e detyrave të punës duke iu referuar kohës nga data 09.10.2024, ndërsa kjo datë rezultonë edhe data e nxjerrjes së Vendimit Nr.5340 e Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, përmes të cilit akt ankuesi ishte transferuar nga pozita Zyrtar i Depos në pozitën Zyrtar i Transportit, dhe ndër tjerash ankuesi kërkon që Këshilli, të shqyrtojë rastin e tij, dhe se i njëjti pretendimin e tij ankimor e mbështet me opinionin e zyrës ligjore lidhur me të drejtat e tij.

Kolegji i Këshillit pas analizoi dhe konstatoi saktë të gjitha veprimet ndërmarra procedurale nga palët në procedurë, konstatim ky i përcaktuar si në arsyetimin e këtij vendimi mbi bazën e provave të ofruara nga palët në procedurë, dhe erdhi në përfundimin se ankuesi lidhur me kërkesën tij duke iu referuar opinionit të zyrës ligjore, e ka pranuar përgjigjen nga Udhëheqësja e Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime, me datë 20.06.2025, për të cilën përgjigje është mbajtur i informuar edhe Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit duke iu referuar dispozitave të nenit 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, mori përbazë dispozitat e aplikuara nga neni 127 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj”,* dhe konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill me datë 03.12.2025 është e palejuar pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit kohor të përcaktuar si në dispozitën e lartcekur, ngase ankuesi përgjigjen lidhur me kërkesën e tij për udhëtime jashtë vendit, e ka pranuar me datë 20.06.2025 përmes e-mailit zyrtar.

Bazuar si me sipër si dhe duke ju referuar provave të lëndës Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e datës 03.12.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil, është e jashtëafatshme sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 127 paragrafi 3 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse e njëjta është parashtruar jashtë afatit prej tre (3) muaj ndaj përgjigjes së datës 20.06.2025, respektivisht njoftimit nga Udhëheqësja e Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nënin 129 paragrafin 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1987/2025, datë 23/01/2026.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, S.Th;
- Ministrisë së Punëve të jashtme dhe Diasporës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.